



Komuna Lipjan

KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS:

KONTRATA

E përpiluar më 08.05.2017

Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga drejtori i prokurimit Adem Duriqi në vazhdim ("Autoriteti Kontraktues"), në njérën anë dhe

NTSH "Dino" shpk nga Lipjani që e përfaqëson Ramadan Salihu Drejtor në vazhdim ("Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për punë e shënuara më poshtë:

"Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shalë – projekt dy vjeçar" me numër identifikues: 613 017 029 521

Neni 1 Lënda

Asfaltimi i rrugicave në fshatin Shalë me gjatësi L=2115 dhe gjerësi B=4m - Duke përfshirë pastrimin e terenit dhe largimin e pengesave, demolimin e gypave që pengojn gjatë trasesë, mbushjen me zhavor dhe ngjeshja e trasesë të gjitha të specifikuara në paramasën e dosjes së tenderit.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi përgjithshëm i punëve është: **96,841.88 €** apo shprehur me fjalë: nëntëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e katërdhjetë e një /euro/ e tetëdhjetë e tetë /centë/.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Çmimet njësi janë të prerë dhe nuk mund t'i nënshtronë ndryshimeve.

2.3 Rishikimi dhe ndryshimi i çmimeve nuk pranohet dhe do te paguhet vetëm shuma e cekur ne nenin 2.1. Në rast se paraqiten pengesa të cilat duhet eliminuar patjetër për realizimin e projektit do të rregullohet me aneks kontratë

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

3.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

3.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

¹ Para nënshkrimit te Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Vecanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbal i mbledhjes informative/vizitës se vendit)

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Vecanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" "ose" "vendosë" "do" të interpretohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për kontraktuesin

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Ramadan Salihu
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.05.2017	Data:	03.05.2017
Vula:		Vula:	

PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupei i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë përbartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuftojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin përvendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkizazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkësë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- humbe ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;

- (b) humbje ose dërmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dërmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dërmtim ose vdekje e personelit te tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuara.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarria në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsyë të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose te eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërbimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 8 Programi

8.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do te përbaje se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor qe kërkohet për dorëzim dhe miratim te vizatimeve, metodat e përgjithshme qe do ti zbatoje, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikit teknike të rëna dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjeter ne lidhje me testimin do ti sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikit teknike të rëna dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund te caktojnë kohën dhe vendin përi-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuara, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

Neni 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikit dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka përqëllim të bëjë kërkesë për zgjatje-të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjeter ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojet.

12.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substancial te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tilla ose te përashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

Neni 13 Korrigimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do te zgjatet deri sa te përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korriguar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

Neni 14 Paramasa dhe Paralogaria

14.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përbajnjë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë pér çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës pashallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktivitetave në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 15 Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose

b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 16 Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkësës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsyë të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

Neni 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbras dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

Neni 20 Parapagimi

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 21 Mbajtja e Parasë

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kaloj periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korriguar. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar "me kërkese".

Neni 22 Siguria e ekzekutimit

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënës në pjesën IV të kontratës.

Neni 23 Kostoja e Riparimeve

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

Neni 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimit te punëve

24.1 Pasi qe kryesish te jene përfunduar te gjitha punët dhe te kenë kaluar te gjitha Testet e kompletimit te punëve te përshkruara ne kontrate, kontraktuesi mund te njoftoj Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do ti kryej te gjitha punët e diskutueshme gjate Periudhës Garantuese te defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se te gjitha punët e diskutueshme do te kompletohen gjate Periudhës garantuese për defekte do te merren si kërkese e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim te Certifikatës-mbi-Pranim te punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve te pranimit te kësaj kërkese Menaxheri i Projektit ose do te lëshoj Certifikatën e pranimit te punëve, duke cekur datën, sipas mendimit te tij, e përfundimit te punëve ose do te jap instrukSIONE për punët te cilat duhet te kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit te kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit te Projektit, ka te drejtën e pranimit te kësaj Certifikate brenda 21 ditëve te kompletimit te punëve dhe te përmirësimit te defekteve te cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

Neni 25 Llogaritja përfundimtare

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit te Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët te cilat duhen ti paguhën Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATA PUBLIKE – HAPUR / Punë

defekte. Menaxheri i projektit do te lëshoj Certifikatën e periudhës garantuese te defekteve dhe do te certifikoj cilëndo pagese finale e cila duhet ti paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit te llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren te meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do te vendos mbi shumën e cila do ti paguhet Kontraktuesit dhe do te lëshoj certifikatën mbi pagesën.

Neni 26 Shkëputja e kontratës

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërpërje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyе të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijuhen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlgimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërpërje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 27 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj Kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërrë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të janë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 29**Lirim i nga Ekzekutimi**

29.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 30 Forca madhore

30.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do tëjenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizoterojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Përgjegjësia dhe Sigurimi Kontraktuesit	7.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianeve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i>; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i>; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianeve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i>; (d) dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	<p>Menaxheri i Projektit është: Valzim Mziu</p> <p><i>Nr tel</i> 044 597 644</p>
Fillimi i punëve	10.1	<p>Data e fillimit do të jetë : 3 Dite nga data e nënshkrimit te kontratës prej 11.05.2017 dhe do të zgjatë jo më shumë se deri më 18 dhjetor 2018.</p> <p>Plani dinamik përfshin kontratë dyvjeçare fiskale (2017-2018) Çdo vonesë pa arsyë më gjatë se plani dinamik i kontraktuar (18 dhjetor 2018) do të konsiderohet shkelje e kontratës dhe do të zbatohen penalet.</p>
Përmirësimi defekteve	13.1	Periudha garantuese e defekteve është 5 Vite. Përveq garacionit të rregullt bankar prej 10% të vlerës së kontratës (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) ne afat 1 vjeçar pas pranimit teknik, kërkohet deklaratë mbi garacionin e cilësisë së punës dhe mallrave në kohëzgjatje 5 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompenzim. Në të kundërtën pajtohet se AK ato dëme do ti sanojë me tjeter OE dhe të njëjtat shpenzime do ti fakturojë Kontraktorit që ka dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Në rast të konzorciumit kjo deklarate ipet në emër të liderit të konzorciumit.

Posedimi i vendpunimit	i	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë : 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës
Dëmet e likuiduara		19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.2 % e vlerës se kontratës/ për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Parapagimi		20.1	Shuma e Parapagimit është: <i>S'ka parapagim</i>
Mënyra e pagesës			Pagesat do të bëhen: sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuara nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrin shuma 90% e mjeteve të paguara. Punimet për vitin 2017 do të kryhen deri në vlerën prej 65.000.00€, ndërsa pjesa tjeter e mbetur prej 31.841.88 do te kryhen në vitin 2018 duke përfshirë edhe 10% të mbajtur nga secila faturë e cili do të paguhet pas lëshimit të Çertifikatës për përdorim dhe dorëzimit të garpcionit për punët e kryera në afat prej 12 muajve
Mbajtja e Parasë		21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% e mjeteve do të mbahen deri në pranimin teknik , ndërsa pas pranimit teknikë të punëve kontraktuesi do të sjellë sigurimin e garpcionit të punëve në afat prej 12 muajve me të cilat do të përdoren përmirësimin e defekteve në rrugë nëse paraqiten gjatë kësaj kohe e kontraktuesi nuk përgjigjet
Siguria ekzekutimit	e	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është : 10 % e vlerës se kontratës apo 9684.18 € në kohëzgjatje prej 20 muaj cila duhet te paguhet me rastin e nënshkrimit te kontratës.
Pagesa shkëputjes kontratës	pas së	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është 10% . <i>Nëse kontraktuesi nuk arrin t'i përfundojë punët e kontraktuara , pozicionet e mbeturë do ti paguaj kontraktuesi +10% nga kontrata.</i>
Pagesa shkëputjes kontratës	pas së	27.2	a. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit; b. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit; c. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet. e Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës. f Nëse për shkak të fajt të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e

		detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëfqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimesinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje. g Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.
Shkaqet shkëputje kontratës	për te	Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj defektet brenda 3ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit; Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për 90 ditë pëndonjë arsy, pas vërejtjes së dhënë nga menaxheri i kontratës , kontrata do të shkëputet në mënyrë të një anshme nga ana e Autoritetit Kontraktues Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	[shëno te dyja] a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Ekonomike në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E RRUGEVE NE FSHATIN SHALE						
Nr.	Përshkrimi i aktiviteteve	Njësia	Sasia	Çmim/ njësi	Vlera në €	
1	Shenjezimi, inqizimi gjeodezik i parcellës Në tërsi dhe bartja e pikave ne terren ne bashkepunim me organin mbikyres. Operatori eshte i obliguar qe gjate gjith kohes te ket gjeodetin ne terren,per percjelljen e punimeve me kordinata gjeodezike sipas detajeve ne projekt. Detyrat e gjeodetit do te jan : a. Inqizimi I gjendjes egzistuese b. Inqizimi I gjendjes pas germimit (Krijimi i siperfaqeve dhe krahasimi me gjendjen egzistuese-nxjerra e sasive te germimit). c. Inqizimi i siperfaqejs pas materialit mbushes dhe stresave tjera te zhavorit-krijimi i siperfaqeve,kalkulimi i sasive.	m'	2,115.00	0.50	1,057.50	

2	Furnizimi, montimi dhe rregullimi i zyreve të përkohshme në vendin e ndërtimit, zyret duhet ti plotesojen kushtet standarte per punë.	copë	1.00	50.00	50.00
3	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohëshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriqimit të kantjerit. Furnizimi me material dhe ndërtimi WC-se se perkoshme.	cope	1.00	50.00	50.00
4	Furnizimi me materiali si dhe vodosja e sinjalizimit adekuat, tabela informuese, shenjat e nevojshme te sigurise ne punë etj.	komplet	1.00	20.00	20.00
5	Transporti I mjeteve, stabilimenteve dhe paisjeve tjera per punë	paushall	1.00	100.00	100.00
6	Punimi I projekti detal te egzekutimit (duke perfshi te gjitha pozicionet e egzekutuara ne terren,te deshmuara dhe me foto),situacionin dhe profilin gjatsor,diagramin e mbushjeve dhe germimeve,te dorzohet ne 3 copje dhe ne cd.	m'	2,115.00	0.10	211.50
7	Egzaminimi i materialeve pas vuarjes ne veper te tyre si : Kubzave,skajoreve dhe elementeve tjera per shqyrtim. Kontraktori është I obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe përadhjen e materialit para fillimit te punimeve . Pastaj pas vuarjes ne veper nga menaxheret e projektit do te merren mostrat ne teren per keto materiale sipas standardeve dhe rregulloreve ne fuqi, dhe do te ekzaminohen ne laborator te pamvarur te percaktuar nga investitori (ne rast te kontesteve), shpenzimet per te gjitha keto pozicione duhet ti bart punkryesi,sipas qmimeve te tregut	komplet	1	1,000.00	1,000.00
8	Demolimi dhe largimi i rrethojave ekzistuese,gardhit gjelbrues dhe pengesave tjera per gjat tere trasese, materiali I demoluar transportohet ne deponi legale	m'	2,115.00	0.20	423.00
9	Gërmimi i dheut i kategorisë së III dhe te V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km,apo deri ne vendin ku e cakton organi mbikqyres	m³	5,498.00	1.50	8,247.00

10	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje 40-50 N/mm ² me cilinder me vibracion,si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes,duhet te behen matjet e nenbazes te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 40-50 N/mm ² -Te deshmuara me ateste,matjet duhet te behen me pllakë rrëthore qdo 50 m' (pa aprovim ne ditarin ndertimor nga menaxheri i kontrates per arritje te kesaj ngjeshmerie nuk lejohet te kalohet ne fazen tjeter)	m ²	13,747.50	0.25	3,436.88
11	Punimi i mbushjes me material guror jokoherent të sjellur nga huaza në largësi deri 15 km me bartje, shtrirje në shtresa dhe ngjeshjematjet duhet te behen me pllakë rrëthore qdo 50 m' te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 50 N/mm ² (pa aprovim ne ditarin ndertimor nga menaxheri i kontrates per finalizim te ketij pozicioni nuk lejohet te kalohet ne fazen tjeter)	m ³	5,400.00	4.00	21,600.00
12	Punimi i bankinave me gjersi 0.80m',me material jokoherent të sjellur nga huaza nga largësia deri 15 km me furnizim bartje, shtrirje dhe ngjeshje	m ³	338.00	4.00	1,352.00
13	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi t=25cm,matjet duhet te behen me pllakë rrëthore qdo 50 m' te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 60 N/mm ² (pa aprovim ne ditarin ndertimor nga menaxheri i kontrates per finalizim te ketij pozicioni nuk lejohet te kalohet ne fazen tjeter)	m ³	3,436.00	6.00	20,616.00
14	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=15cm,me ngjeshje me cilinder me vibracion,si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes,duhet te behen matjet e nenbazes te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 70-80 N/mm ² -Te deshmuara me ateste ,matjet duhet te behen me pllakë rrëthore qdo 50 m' (pa aprovim ne ditarin ndertimor nga menaxheri i kontrates per finalizim te ketij pozicioni nuk lejohet te kalohet ne fazen tjeter)	m ³	1,903.00	7.00	13,321.00
15	Furnizimi dhe punimi i shtresës së bitoagregatit 0-16 mm me trashësi t=7 cm,duke perfshi edhe kyqjet sekondare te rrugeve	m ²	8,660.00	1.20	10,392.00
16	Punimi I leshesave Gypore nga betoni me diameter Ø 600 mm,ne qmim te perfshihet e sipas detajeve ne projekt, te deshmuara me ateste.	m'	60.00	2.00	120.00

17	Punimi I leshesave Gypore nga betoni me diameter Ø 500 mm,sipas detajeve ne projekt, te deshmuara me ateste.	m'	320.00	16.00	5,120.00
18	punimi I kokave te leshesave si ne pos e me siperm dhe sipas detajeve ne projekt,me beton te klases C25/30 te deshmuara me ateste.	m ³	67.00	60.00	4,020.00
19	Hapja e kanaleve per gjat rruges ne te dy anet e rruges,ne ato pjese ku eshte e mundshme te behet hapja e tyre,me dim 80*50 cm'	m'	4,230.00	0.50	2,115.00
20	Ngritja e pusetave,nivelizimi si dhe montimi I kapakeve per gjat trupit te rruges (pasi qe nje pjese e madhe e kanalizimit fekal egzistues kalon neper trup te rruges egzistuese),kapaket duhet tejen per pesha te renda (metalike) deri ne 40 T	cope	46.00	65.00	2,990.00
21	Dislokimi I shtyllave elektrike nga trupi I rruges ne ate pjese ku pengon zhvillimin e trasese,me te gjith materialin e nevojshem per dislokim (kabell dhe elementet tjera deri ne funksionalizim.	cope	6.00	100.00	600.00
	Vlera e përgjithshme				96,841.88